

Dalës-izlazo

Nr. 11-557
Br.

Data 17.06.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government



Komuna Obiliq - Opština Obilic - Municipality Obiliq

Datë/Data/Date	17/06/2020
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës së Obiliqit- Xhafer Gashi
Për/Za/To:	Kryesues i Kuvendit Komunal Obiliq –Burim Gerguri
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkesë për ndërrim e kulturës ne parcelën me Nr.P-72614055-01842-8

Të nderuar

Duke u bazuar në Vendimin Përfundimtar Nr.II-77 të dt.22.02.2013 për shpronësimin e ngastrave kadastrale të cilat janë prekur me rastin e asfaltimit të ndërtimit Projektit – Rrugës Unazë – Paralel me Rrugën Kryesore në Obiliq në mesin e parcelave kadastrale të cilat janë shpronësuar është edhe pjesa nga parcela kadastrale Nr.01842/1 zk.Obiliq me sipërfaqe prej 60032 m² (sipërfaqja e shpronësuar 6142 m²) pas ndarjes së parcelës me Nr.01842/1 pjesa e cila ka kaluar në pronësi të Kuvendit Komunal Obiliq ka marrë numër të ri dhe sipas gjendjes së fundit në kadastër evidentohet Nr.P-72614055-01842-8 me sipërfaqe 6142 m² .

Me qenë se sipërfaqja e shpronësuar për rrugë është mjaftueshme, ne si Komunë kemi planifikuar që në një pjesë të kësaj parcele respektivisht në pjesën ku e shfrytëzon z.Abdyrrahman Thaqi si lokacion për shitjen e material ndërtimor (shih skicën) të ndërtohet tregu i gjelbër, andaj kërkojmë nga ana e juaj që të bëni ndërrimin e Llojit të shfrytëzimit të parcelës dhe Shfrytëzimit aktual të parcelës nga **Infrastruktura – Rrugë e Rendit I** në tokë ndërtimore në mënyrë që ne si ekzekutiv të mund të procedojmë më tutje me projektin në fjalë .

Me respekt !